



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM**  
**SEKTORI I FINANCËS**

---

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më 24.02.2017

**Drejtuar :** **MINISTRISË SË FINANCEVE**  
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT**  
**DREJTORIA E MONITORIMIT DHE MENAXHIMIT TË BUXHETIT**

**TIRANË**

**Subjekti: Mbi raportin e monitorimit të buxhetit për vitit 2016.**

Në mbështetje të Ligjit nr. 147/2015, datë 17.12.2015 për buxhetin e vitit 2016, dhe në vijim të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 2, datë 06.02.2012, për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit, udhëzimit plotësues të Ministrit të Financave nr. 1, datë 15.01.2016 për zbatimin e buxhetit të vitit 2016, Aktit Normativ nr. 1, datë 29.07.2016 për disa ndryshime në Ligjin nr. 147/2015, për buxhetin e vitit 2016 si dhe në Aktin Normativ nr. 2, datë 16.12.2016 për disa ndryshime në Ligjin nr. 147/2015, për buxhetin e vitit 2016 për vitin 2016, Udhëzimit nr 22 datë 17.11.2016 për procedurat standarde të monitorimit performanca e produkteve të buxhetit, lutemi gjeni bashkëlidhur Raportin e Monitorimit të Buxhetit të vitit 2016 të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Raporti i monitorimit të vitit 2016 krahas analizës së shpenzimeve buxhetore në nivel programi përmban dhe një analizë të detajuar të objektivave institucionale referuar performancës buxhetore të orientuar drejt rezultateve.

Duke Ju falënderuar për frymën bashkëpunuese,

**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM**

**LULJETA NANO**

## **PËRMBAJTJA**

<i>-Hyrje.....</i>	<i>3.</i>
<i>-Raport i monitorimit të buxhetit të shtetit të vitit 2016.....</i>	<i>3-6</i>
<i>-Analiza e realizimit të buxhetit të KLSH-së për vitin 2016.....</i>	<i>7-8</i>
<i>-Analiza e objektivave institucionale të KLSH-së, referuar buxhetit të orientuar në rezultate.</i>	
<i>-Mbi realizimin e objektivave të menaxhimit institucional.....</i>	<i>9-20</i>
<i>-Aneksi Nr 1- Raporti i Shpenzimeve sipas Programeve.....</i>	<i>21</i>
<i>-Aneksi Nr 2- Raporti i shpenzimeve të Programit sipas artikujve buxhetorë.....</i>	<i>22</i>
<i>-Aneksi Nr 3- Raporti përmbledhës i realizimit të treguesve të performancës /produkteve të programit.....</i>	<i>23</i>
<i>-Aneksi Nr 4- Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit.....</i>	<i>24</i>
<i>-Aneksi Nr 5- Projektet e investimeve me financim të brendshëm dhe të huaj.....</i>	<i>25</i>

## **HYRJE**

Monitorimi i buxhetit të vitit 2016 për institucionin e KLSH-se përfaqëson procesin e vlerësimit të performancës së fondeve buxhetore nëpërmjet krahasimit të treguesve faktikë të performancës me ato të planifikuar. Në vijimësi GMS dhe strukturat respektive të KLSH-së kanë kryer monitorimin e treguesve buxhetore më qëllim ndjekjen në vijimësi të objektivave të synuar dhe të përcaktuar në Deklaratën e politikës së programit të KLSH-së të përfshirë në Strategjinë e Zhvillimit Institucional 2013-2017 e rishikuar.

Nëpërmjet këtij raporti monitorimi evidentohet niveli i realizimit të fondeve buxhetore të KLSH-së të detajuar në nivel kategori shpenzimi buxhetor kundrejt treguesve të planifikuar duke mundësuar në këtë mënyrë riorientimin dhe sigurimin e një informacioni shtesë për të përmirësuar procesin e planifikimit dhe të menaxhimit të buxhetit.

## **RAPORT I MONITORIMIT TË BUXHETIT TË SHTETIT TË VITIT 2016**

### **I-Analiza e Realizimit të Shpenzimeve në Nivel Programi**

#### **Programi 01120 “Veprimtari audituese e Kontrolli të Lartë të Shtetit ”**

Buxheti i akorduar për programin ÷Veprimtari auditueses e KLSH-së, ka në bazë të tij Deklaratën e Politikës Programi (DPP) të hartuar gjatë procesit të PBA 2016-2018 dhe është në funksion të realizimit të politikës së përcaktuar në dokumentin themelor të zhvillimit institucional që është Strategjia e zhvillimit të KLSH-së 2013-2017 e rishikuar. . Politika buxhetore e këtij programi, ka si qëllim, përmbushjen me cilësi të lartë dhe në kohë të detyrimeve kushtetueses dhe ligjore, të objektivave si dhe prioriteteve të institucionit të parashikuar në Planin e Zhvillimit Strategjik 2013-2017 të ripunuar, duke konsideruar kërkesat e organizmave ndërkombëtarë të auditimit dhe të BE-së të përcaktuara në MSA-në e Shqipëri-BE dhe të monitoruara nga DG Budget, në kuadrin e Integrimit European.

#### **“Raporti i Shpenzimeve Faktike të Programit sipas Artikujve për vitin 2016”**

Në zbatim të Ligjit 147/2015, ÷Për buxhetin e vitit 2016, dhe shkresës së Ministrisë së Financave nr. 17761/124, datë 11.01.2016 ÷Mbi detajimin e buxhetit të vitit 2016, Aktit Normativ nr. 1, datë 29.07.2016 ÷Për disa ndryshime në ligjin nr. 147/2015, ÷Për buxhetin e vitit 2016, si dhe Aktit Normativ nr. 2, datë 16.12.2016 ÷Për disa ndryshime në Ligjin nr. 147/2015, ÷Për buxhetin e vitit 2016, është bërë miratimi i çeljes me ndryshimet e fondeve buxhetore për vitin 2016 për institucionin e Kontrollit të Lartë të Shtetit

Fondet e alokuara për funksionimin e aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, sipas programit, për vitin 2016 paraqiten sipas tabelës së poshtë:

000/Lekë

Grupi	24	Shpenzimet e Kontrollit te Larte te Shtetit					Kodi	1024001
Programet		(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(7)=(6)-(5)	
Titulli	Emertimi	Fakti 2015	PBA 2016	Buxheti 2016	Buxheti i Rishikuar 2016	Realizimi (Fakti ) 2016	Diferenca	
0001	Veprimtari Audituese E KLSH	326.017,1	352.000	532.150,0	496.847,8	464.147,5	32.700,3	
Shpenzime nga te Ardhurat Jashte limitit								
Totali		326.017,1	352.000	532.150,0	496.847,8	464.147,5	32.700,3	

Tabela në vijim paraqet, **Raportin e Shpenzimeve të Programit sipas Artikujve:**

000/Lekë

Grupi	24	Totali Shpenzimeve						Kodi	1024001
Programi	Veprimtaria Audituese e K.L.Sh.							Titulli	01120
Artikulli	Emri	Fakti 2015	PBA 2016	Buxheti 2016	Buxheti i Rishikuar 2016	Realizimi (Fakti ) 2016	Vlera e Mbetur		
600	Paga	208.334,2	219.000,0	241.000,0	228.600,0	221.173,20	7.427		
601	Sigurime Shoqërore	30.815,0	27.000,0	20.000,0	32.400,0	32.367,80	32		
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	74.718,1	85.850,0	87.000,0	87.000,0	71.162,50	15.838		
605	Transferta Korente të Huaja	129,0	150,0	150,0	150,0	126,60	23		
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	727,7			397,8	397,80	0		
<b>Totali</b>	<b>Shpenzime Korrente</b>	<b>314.724,0</b>	<b>332.000,0</b>	<b>348.150,0</b>	<b>348.547,8</b>	<b>325.227,90</b>	<b>23.320</b>		
230	Kapitale të Patrupsuara		20.000,0	10.900,0	10.900,0	5.051,50	5.849		
231	Kapitale të Trupsuara	11.293,1		73.100,0	2.400,0	1.389,10	1.011		
232	Transferta Kapitale						0		
<b>Totali</b>	<b>Shpenzime Kapitale</b>	<b>11.293,1</b>	<b>20.000,0</b>	<b>84.000,0</b>	<b>13.300,0</b>	<b>6.440,60</b>	<b>6.859</b>		
230	Kapitale të Patrupsuara /Financimi i Huaj			100.000,0	135.000,0	132.479,00	2.521		
<b>Totali</b>	<b>Korrente dhe Kapitale</b>	<b>326.017,1</b>	<b>352.000,0</b>	<b>532.150,0</b>	<b>496.847,8</b>	<b>464.147,50</b>	<b>32.700,3</b>		

## ANALIZA E REALIZIMIT TË BUXHETIT TË KLSH-së PËR VITIN 2016

### **1- Pagat, Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore. Llogaria 600-601**

Fondi i alokuar nga buxheti i shtetit për vitin 2016 për zërin Paga dhe Sigurime është 261,000 mijë lekë, nga të cilat:

- Pagat nga 228,600 mijë lekë të planit vjetor janë shpenzuar në vlerën 221,173.2 mijë lekë ose në masën 96,7%
- Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore nga 32,400 mijë lekë të planit vjetor janë shpenzuar në vlerën 32,367.8 mijë lekë ose në masën 99.9%

Shuma e shpenzuar në zërin Shpenzime Personeli, përfshin pagat e punonjësve të KLSH-së dhe të ekspertëve të jashtëm të përkohshëm të kontaktuar dhe paguar komform shkresave dhe kontratave të nënshkuara me ta.

### **2- Shpenzime Operative. Llogaria 602**

Fond i alokuar nga buxheti i shtetit për vitin 2016 është 87,000 mijë lekë, ku fond i planifikuar për Shpenzime për Mallra dhe Shërbime, për vitin 2016 është shpenzuar në masën 71,162.5 mijë lekë ose në masën 82 %. Me këtë zë shpenzimesh janë përballuar nevojat administrative si shpenzime për drita, ujë, telefon, shpenzime kancelari, shpenzime për mirëmbajtje etj.

Në këtë artikull një pjesë të konsiderueshme e zënë shpenzimet për trajnime jashtë dhe brënda vendit dhe për dieta në funksion të veprimtarisë audituese. Ngritja e Kapaciteteve është një nga objektivat Strategjikë të KLSH që parashikohet në Strategjinë e Zhvillimit 2013 -2017 e ripunuar 2015-2017. Për arritjen e këtij objekti, KLSH përgjatë vitit 2016, ka marrë pjesë në mënyrë aktive në shume aktivitete trajnime, takime dhe grupe pune, konferenca dhe simpoziume, të cilat kanë synuar ndërtimin e kapaciteteve , rritjen e aftësive dhe njohurive profesionale të audituesve në funksion të rritjes së cilësisë së auditimit. Organizimi dhe pjesëmarrja në këto aktivitete janë shoqëruar me kostot përkatëse duke u fokusuar në menaxhim sa më të kujdesshëm dhe përdorim sa më me efektivitet.

### **3- Transferta korrente dhe të huaja. Llogaria 605**

Gjatë vitit 2016, janë shlyer detyrimet për kuota anëtarësimi për organizatat INTOSAI dhe EUROSAI, në shumën 127 mijë lekë nga 150, mijë lekë të planifikuara.

### **4- Transferta për buxhetet familjare. Llogaria 606**

Gjatë vitit 2016, është dhënë Fond i Veçantë me kërkesat e bëra nga ana jonë dhe të konfirmuara nga Ministria e Financave në vlerën 397,8 mijë lekë, për daljen e punonjësve në pension, rast fatkeqësie dhe sëmundjeje dhe është realizuar në masën 397,8 mijë lekë ose 100% të planifikimit.

### **5- Shpenzime për investime kapitale. Llogaria 230, 231**

Bazuar në Ligjin nr. 147/2015, datë 17.12.2015 ÷Për buxhetin e vitit 2016÷, plani i buxhetit me destinacion Investimet Kapitale ishte në shumën 184,000 mijë lekë nga të cilat 84,000 mijë lekë investime me Financim të Brendshëm dhe 100,000 mijë lekë Investime me Financim të Huaj. Me Aktin Normativ nr. 1, datë 29.07.2016, ÷Për disa ndryshime në ligjin nr. 147/2015 ÷Për buxhetin e vitit 2016÷ , u bënë ndryshime në zërin Investime me Financim të Brendshëm duke zbritur vlerën prej 9,000 mijë lekëshe me Aktin Normativ nr. 2, datë 16.12.2016 ÷Për disa ndryshime në Ligjin nr. 147/2015, ÷Për buxhetin e vitit 2016÷ u bënë ndryshime në zërin Investime me Financim të Brendshëm dhe të Huaj.

Tabela në vijim paraqet planin dhe realizimin e buxhetit të Investimeve për vitin 2016, i detajuar sipas zërave.

#### **Shpenzime për Investime Kapitale**

*1-Financim i Brendshëm*

*/000 Lekë*

Llog	Kod Projekti	Emertimi i Projektit	Buxheti 2016	Buxheti i Rishikuar	Fakti	Vlera e mbetur
2310000	M240013	Informatizimi i sistemit të menaxhimit të auditimit	41.000	0		
2310000	M240014	Ndërtim Godine Nr. 2	29.700	0		
2310000	M240005	Pajisje kompjuterike	1.000	1.000	918,90	81,10
2310000	M240010	Pajisje të ndryshme zyre	1.400	1.400	470,10	929,90
		<b>Shpenzime Kapitale/Investime</b>	<b>73.100</b>	<b>2.400</b>	<b>1.389,00</b>	<b>1.011,00</b>
2300000	M240015	Projektimi i objektit "Ndërtim godina nr 2"	4.000	4.000	3.480,00	520,00
2300000	M240012	Kosto lokale projekti IPA	6.900	6.900	1.571,50	5.328,50
		<b>Shpenzime Kapitale/ Projekte</b>	<b>10.900</b>	<b>10.900</b>	<b>5.051,50</b>	<b>5.848,50</b>
		<b>Totali Financimi i Brendshëm</b>	<b>84.000</b>	<b>13.300</b>	<b>6.440,50</b>	<b>6.859,50</b>

Nga analiza faktoriale e buxhetit të investimeve sipas zërave konstatohet se, buxheti i investimeve të planifikuara për zërin ÷Paisje kompjuterike ÷ është realizuar ne masen 918,9 mijë lekë nga 1,000 mijë lekë të planifikuara ose është realizuar në masën 100%.

Buxheti i investimeve të planifikuara për zërin ÷Paisje të ndryshme zyre ÷ është realizuar ne masen 470 mijë lekë duke reflektuar një kursim ne fondet e prokuruarra prej 929,1 mijë lekë, kjo si rezultat i zbatimit te procedurave te prokurimit dhe nivelit te larte te konkurrencës se ofertimit në këto procedura.

Fondi prej 4,000 mijë lekë i planifikuar për Projektimin e Godinës së KLSH është përdorur në masën 3,480 mijë lekë duke rezultuar me një kursim prej 520 mijë lekë.

Fondi prej 6,900 mijë lekë i planifikuar për Kosto lokale e projektit IPA është përdorur në masën 1,571 mijë lekë duke rezultuar me një kursim prej 5,328 mijë lekë. Në këtë artikull një pjesë të konsiderueshme e zënë shpenzimet e udhëtimit për trajnime jashtë vendit si dhe për marrjen me qera të ambienteve ku janë zhvilluar trajnimet e stafit. Referuar sa më lart një pjesë e madhe e trajnimeve janë kryer në ambientet e KLSH-së dhe si rezultat kemi pasur një kursim të këtyre fondeve.

### **Investime me financim të huaj**

Për vitin 2016, janë parashikuar fonde për realizimin e projekteve me Financim të Huaj në vlerën 135,000 mijë lekë dhe që i përket projektit IPA 2013 ÷Forcimi i kapaciteteve të auditimit të jashtëm÷.

#### *2-Financim i Huaj*

*/000 Lekë*

Llog	Kod Projekti	Emertimi i Projektit	Buxheti 2016	Buxheti i Rishikuar	Fakti	Vlera e mbetur
		Projekti IPA -Forcimi i kapaciteteve te auditimit	100.000	135.000	132.479	2.521
		<b>Shpenzime Kapitale/Investime</b>	<b>100.000</b>	<b>135.000</b>	<b>132.479</b>	<b>2.521</b>

Zbatimi i projektit IPA2013, i cili e përkufizon KLSH-në si në institucion modern evropian i auditimit suprem publik, i cili e bazon tërësisht aktivitetin e tij në standartët INTOSAI-t. Në mars 2016 ka filluar implementimi i projektit të binjakëzimit në KLSH. Gjatë vitit 2016 janë implementuar 36 misione, të cilat lidhen me implementimin e kornizës legjislativë për auditimin, zhvillimin e metodologjive të auditimit dhe kapaciteteve audituese si dhe forcimin e kapaciteteve institucional të KLSH dhe përmirësimin e impaktit të rezultateve të auditimit. KLSH nëpërmjet përfshirjes së të gjithë strukturave të tij, mbetet e angazhuar për implementimin e suksesshëm të këtij projekti, i cili synon modernizimin e institucionit. ( Më hollësisht është trajtuar ne kapitullin e objektivave institucionale referuar buxhetit te orientuar ne rezultate) .

## **ANALIZA E OBJEKTIVAVE INSTITUCIONALE TË KLSH-së, REFERUAR BUXHETIT TË ORIENTUAR NË REZULTATE**

Viti 2016 për institucionin e KLSH është viti i vazhdimësisë së konsolidimit të reformës institucionale në funksion të përmbushjes së objektivit kushtetues dhe ligjor të sigurimit të llogaridhënies publike. Gjithë veprimtaria audituese e KLSH-së reflekton më së miri dhe është produkt i ndryshimeve të thella rrënjësore në drejtim të implementimit të kërkesave të standardeve ndërkombëtare gjate ushtrimit të veprimtarinë audituese.

Performanca buxhetore e Objektivave institucionale të KLSH-së ne këtë raport paraqiten në dy shtylla kryesore

### **1-Veprimtaria audiuese e KLSH-se**

#### **2-Menaxhimi I zhvillimit institucional.**

### **1- Veprimtaria audiuese e KLSH-se për vitin 2016**

Bazuar në detyrimet ligjore kushtetuese KLSH ushtron auditime në njësitë e sektorit kundrejt nje plani të miratuar vjetor I cili hartohet bazuar në kriterin e vlerësimit të riskut.

#### *Drejtimet kryesore të veprimtarisë audituese të ushtruar nga KLSH për vitin 2016 janë:*

- Zbatimi i dispozitave ligjore në fushën ekonomike, financiare, fiskale e kontabël, me synim identifikimin e gjendjes reale, të metat apo parregullsitë e mundshme në menaxhimin dhe përdorimin e fondeve publike, dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e menaxhimit të financave publike.
- Respektimi i dispozitave dhe i procedurave ligjore në kryerjen e veprimeve financiare, në fushën e të ardhurave dhe shpenzimeve, duke u fokusuar ne veçanti në auditimin e ligjshmërisë në prokurimin e fondeve publike, si dhe në auditimin e shpenzimeve kapitale me burim të brendshëm dhe të huaj financimi.
- Rregullshmëria dhe korrektësia e mbajtjes së dokumentacionit financiar dhe atij kontabël.
- Zbatimi i kërkesave të përcaktuara ligjore mbi paraqitjen e llogarive vjetore për raportimet buxhetore nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme.
- Funksionimi i sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe organizimin e funksionimin e auditimit të brendshëm në sektorin publik.
- Kryerja e auditimeve të performancës si një prioritet i veprimtarisë audituese të KLSH-së e orientuar drejt praktikave më të mira të fushës.

Rezultatet përfundimtare të auditimeve të kryera dhe masat e rekomanduara për përmirësimin e gjendjes për çdo subjekt të audituar, u janë dërguar të gjithë subjekteve të audituara dhe, në disa raste të veçanta edhe institucioneve të tyre drejtuese.

Gjykuar në rëndësinë apo peshën që kanë zënë gjetjet në kontekstin e përdorimit të fondeve buxhetore, raportet dhe masat e rekomanduara u janë dërguar edhe institucioneve më të larta drejtuese të shtetit.

Për periudhën Janar-Dhjetor 2016, Kontrolli i Lartë i Shtetit, nga 154 auditime të planifikuara për auditim ka përfunduar dhe evaduar 154, si dhe ka ushtruar dhe ka vijuar me përgatitjen e materialeve për 170 auditime, nga të cilat:

**154** janë të përfunduar e të evaduar, ku:

-118 (njëqind e tetëmbëdhjetë) janë auditime të përputhshmërisë (ligjshmëri e rregullshmëri financiare);

- 07 (shtatë) janë auditime financiare
- 14 (katërbëdhjetë) auditime tematike
- 13 (trembëdhjetë) auditime performance
- 2 (dy) auditim IT.

2 janë të përfunduar si proces auditimi në subjekt, por të pa evaduar dhe 14 janë në proces auditimi.

#### **Auditimet e përfunduar e të evaduar janë ushtruar në:**

• Ministrinë dhe institucionet qendrore	í í í í í í í í í í í í	37
• Institucionet e administratës së qeverisjes vendore dhe njësi të tjera në nivel vendor		51
• Drejtorinë dhe degët e tatimeve e doganave	í í í í í í í í ..í	14
• Institucionet financiare dhe shoqëritë me kapital të përbashkët shtetëror		20
• Njësitë dhe projektet me financime të huaja		7
• Subjekte të mbrojtjes së mjedisit		6
• Institucione në të cilat është kryer 13 auditime performance (qendrore dhe vendore)		105

Auditimet në institucionet e administratës së qeverisjes vendore e njësi të tjera në nivel vendor dhe auditimet në ministrinë e institucionet qendrore zënë përqindjen më të lartë, konkretisht:

- Institucionet në nivel qendror dhe vendor në të cilat është kryer auditim performance zënë 44% të totalit të auditiveve.
- auditimet në institucionet e administratës së qeverisjes vendore e njësi të tjera në nivel vendor zënë 21% të totalit të auditiveve
- auditimet në ministrinë dhe institucionet qendrore zënë 15% të totalit të auditiveve.
- auditimet në institucionet financiare dhe në shoqëritë me kapital të përbashkët shtetëror 8%,
- auditimet në drejtorinë e degët e tatimeve dhe doganave zënë 6%
- auditimet në njësitë dhe projektet me financime të huaja 3%
- auditimet në subjektet e mbrojtjes së mjedisit 3%.

Nga auditimet e ushtruara gjatë kësaj periudhe janë konstatuar:

**A. Parregullsi dhe shkelje financiare, në të ardhurat dhe në shpenzimet e kryera, me dëm ekonomik në shumën totale prej 25,484 milion lekë, afërsisht 188 milion euro.**

**B. Shkelje të disiplinës financiare me ndikim negativ në performancën e subjekteve të audituara, në shumën totale prej 46,844 milion lekë, 346 afërsisht milion euro, nga e cila: 35,919 milion lekë në fushën e të ardhurave dhe 10,925 milion lekë në fushën e shpenzimeve.**

**Në total janë konstatuar shkelje në shumën 72,328 milion lekë, afërsisht 534 milion euro.**

Këto shkelje financiare përgjithësisht i përkasin veprimtarisë ekonomiko-financiare për periudhën kohore 2013-2015, përcaktuar për çdo subjekt të audituar në programet e auditimit dhe pjesërisht periudhës kohore 2015-deri në shtator 2016.



## **MBI REALIZIMIN E OBJEKTIVAVE TE MENAXHIMIT INSTITUCIONAL ZHVILLIMET DHE REFORMA INSTITUCIONALE**

Boshti kryesor i filozofisë menaxheriale institucionale, përgjatë vitit 2016 ka qenë fokusimi në përmbushjen e objektivave strategjike në kuadrin e reformimit institucional për përafrimin e kuadrit rregullator ligjor dhe metodologjik të veprimtarisë së KLSH-së në një linjë me standardet Ndërkombëtare të Auditimit Publik (ISSAI).

### **Strategjia për Menaxhim dhe Zhvillim**

Zgjerimi i fushës audituese me ligjin e ri organik të KLSH 154/2015 lindi nevojën e rishikimit të *Strategjisë së Zhvillimit Institucional 2013-2017* dhe Planit të Veprimit për periudhën 2015- 2017. Rishikimi i Strategjisë, synoi vendosjen e prioriteteve dhe alokimin e drejtë e të përshtatshëm të burimeve, duke u fokusuar në arritjen e objektivave dhe menaxhimin e risqeve, në përputhje me detyrimet që burojnë nga Ligji Organik.

**Menaxhimi i ndryshimit nëpërmjet sigurimit të vijueshmërisë së implementimit të objektivave të** Strategjisë së Zhvillimit të KLSH-së 2013-2017 (e ripunuar), ka vijuar me fokusimin në 6 objektivat prioritare të modernizimit institucional:

- a) Zgjerimi i kapaciteteve institucionale në drejtim të thellimit dhe zhvillimit të kuadrit rregullator në një linjë me Standartet ISSAI.
- b) Rritja e kapaciteteve audituese dhe e cilësisë së veprimtarisë audituese
- c) Konsolidimi dhe rritja e auditimeve të performancës.
- d) Zhvillimi dhe konsolidimi si dhe rritja e numrit të auditimeve IT dhe përdorimit të IT në auditim
- e) Rritja e kontributit të KLSH-së në luftën kundër korrupsionit
- e) Rritja e ndikimit përmes komunikimit dhe bashkëpunimit

Mund të konfirmohet që objektivat strategjike të sipërcituara kanë qenë në fokus të veprimtarisë menaxheriale institucionale dhe janë arritur në një nivel të kënaqshëm përgjatë gjithë periudhës së implementimit të strategjisë.

Menaxhimi i ndryshimit dhe reformimit institucional gjatë vitit 2016 është realizuar duke ndjekur hapat e mëposhtme:

-*Rivlerësim i vazhdueshëm*, duke përditësuar, përshtatur dhe zgjeruar dimensionet objektivave strategjike nëpërmjet nën/objektivave.

-*Sigurimi i monitorimit* si një proces, i cili mundëson përditësimin e objektivave duke i shtuar vlerë strategjisë për zhvillim institucional.

-*Hartimi i Raportit të Monitorimit të Strategjisë* në nivel vjetor. Për këtë me vendim të Kryetarit nr. 123 datë 29.09.2016, është miratuar Raporti i Monitorimit të Strategjisë së Zhvillimit të KLSH-së 2013-2017 (e ripunuar). Përgjatë vitit 2016 u krye procesi i monitorimit të strategjisë duke mundësuar në këtë mënyrë përditësimin e objektivave duke i shtuar vlerë strategjisë për zhvillim institucional. Mund të konfirmohet që menaxhimi strategjik institucional është udhëhequr drejt normave dhe parimeve ndërkombëtare të auditimit të jashtëm publik si dhe në konvergencë të plotë me Strategjinë e zhvillimit të EUROSAT-t dhe të INTOSAT-t.

KLSH në vijimësi ka synuar **konsolidimin e një qeverisje efektive institucionale**, nëpërmjet kryerjes së analizave SËOT si një instrument menaxherial si në nivel institucional ashtu dhe në nivel departamenti dhe drejtorie.

Nëpërmjet këtyrë analizave mundësohet sigurimi i identifikimit të faktorëve potencialë që ndikojnë në arritjen e objektivave dhe rritjen e performancës institucionale, por jo vetëm mundësohet identifikimi aspekteve menaxheriale që duhen përmirësuar, mundësive apo dhe rreziqeve të ndryshme në funksion të një vendimmarrje sa më efektive dhe përmbushjes së pritshmërive të objektivave strategjike

### **Strategjia e Implementimit të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI.**

Në një linjë me Strategjinë e Zhvillimit të Institucionit, u përgatit **Strategjia e Implementimit të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI** mbi bazën e Marrëveshjes së nënshkruar me 12 mars 2013 me IDI-n, institutin e zhvillimit të INTOSAI-t. Përdorimi i teknikave ICAAT (teknikave të vlerësimit të përputhshmërisë) na mundësoi të identifikonim kërkesat e ISSAI-ve për çdo lloj auditimi, duke hapur kështu rrugën për një analize SËOT për secilin lloj auditimi që kryen KLSH. Procesi i implementimit të standardeve ISSAI është dinamik dhe në funksion të vetë zhvillimit të tij. Kjo duket qartë dhe nga niveli më i lartë i përmbushjes të objektivave të Strategjisë gjatë vitit 2016, i shprehur në mënyrë më të detajuar në matricën e implementimit pjese e Raportit të Monitorimit të kësaj strategjie i cili është miratuar me Vendimin e Kryetarit nr. 123 datë 29.09.2016. KLSH në kuadër të përmbushjes së objektivit strategjik, për zhvillimin e standardeve kombëtare të auditimit përgjatë vitit 2016 ka përkthyer dhe publikuar ISSAI-të e përditësuara si një bazë e rëndësishme për zhvillimin e standardeve nga vete institucioni i KLSH-së dhe konkretisht:

-ISSAI 100 ÷ Parimet themelore të Auditimit në Sektorin Publik

-ISSAI 200 ÷ Parimet themelore të Auditimit Financiar

-ISSAI 300 ÷ Parimet themelore të Auditimit të Performancës

-ISSAI 400 ÷ Parimet themelore të Auditimit të Përputhshmërisë

Raporti i monitorimit të Strategjisë së Implementimit të ISSAI-ve i përgatitur dhe publikuar përgjate vitit 2016 dëshmoi për një ndjekje zbatim rigoroz të përmbushjes së objektivave por jo vetëm është dëshmi e përpjekjeve institucionale për të progresuar drejt implementimit të plotë të Standardeve ISSAI.

Nga monitorimi ka rezultuar përmbushja e objektivave dhe e planit të veprimit dhe aktiviteteve në funksion të arritjes së pritshmërive të progresit dhe modernizimit institucional.

**Implementimi i ISSAI-ve** është një proces i gjatë dhe ndërthuret dhe me veprimtaritë dhe aktivitetet e KLSH që po kryhen në kuadër të zbatimit të projektit IPA 2013 ÷ Forcimi i Institucionit Suprem të Auditimit.

### **Hartimi dhe implementimi i Manualeve të auditimit financiar dhe të përputhshmërisë. Kryerja e auditimeve pilot përgjatë vitit 2016.**

Në kuadër të zbatimit të kërkesave të Strategjisë së Menaxhimit institucional 2013-2017 (të ripunuar), të Strategjisë së Implementimit të ISSAI-ve dhe të aktiviteteve të parashikuara në Strategjinë e Menaxhimit të Financave Publike 2014-2020 Shtylla 6, si dhe në përmbushje të kërkesave të Programit Buxhetor Trigger Matrix, në dhjetor 2015 u ngritën grupet e punës për hartimin e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë dhe Manualin e Auditimit Financiar.

*Të dy Manualët janë hartuar bazuar në kërkesat e standardeve ISSAI, të përcaktimit të prioriteteteve dhe hartimit të Strategjisë së Implementimit të Standardeve Ndërkombëtare*

*ISSAI 2015-2016, në kërkesat e Udhërrëfyesve të IDI-t INTOSAI, ISSAI-ve dhe praktikave më të mira të fushës (Manuali i Gjykatës Europiane të Audituesve)*

Manualet u miratuan nga Kryetari i KLSH-së me 31.12.2015 dhe iu dërguan Delegacionit Europian dhe SIGMA-s për dhënie mendimi dhe opinionit në funksion të përmirësimit të tyre.

#### ***-Kryerja e auditimeve pilot në funksion të testimit të manualeve të auditimit***

Për vitin 2016 referuar Programit Buxhetor Trigger Matrix, pjesë e Strategjisë së Menaxhimit Financiar Publik 2014-2020 KLSH kishte detyrimin të kryente 13 auditime pilot 3 Auditime financiare dhe 10 auditime përputhshmërie, bazuar në Manualet e mësipërme në funksion të testimit të tyre në praktikë dhe përmirësimin e manualeve të hartuara. KLSH në fund të vitit 2016, përmbushi kryerjen e auditimeve pilot konform detyrimeve të përcaktuara nga Matrica e zbatimit të programit buxhetor të Strategjisë së Menaxhimit të Financave publike dhe është në pritje të kryerjes së misionit të shqyrtimit nga ekspertet e SIGMAS.

KLSH në një linjë me rekomandimin e adresuar nga BE që KLSH të rrisë numrin e auditimeve pilot financiare/ të përputhshmërisë/ rregullshmërisë, në përputhje me manualet e përditësuara dhe standardet e auditimit të INTOSAI-të. (Progres-Raporti 2016 për Shqipërinë, faqe 85) në planin e veprimtarisë audituese të vitit 2017 ka planifikuar që të rrisë në mënyrë progresive me rreth 40 % pilotimi i auditimeve të përputhshmërisë dhe e shprehur në terma konkrete numri i auditimeve të përputhshmërisë do të rritet nga 10 auditime përputhshmërie në 14 auditime që do të kryhen përgjatë vitit 2017.

Zhvillimi i auditimeve financiare, dhënia e opinionit për pasqyrat financiare do të përbëjë një nga prioritetet e veprimtarisë audituese. Në planin e veprimtarisë audituese të vitit 2017 do të rritet në mënyrë progresive duke dyfishuar numrin e auditimeve pilot financiare dhe e shprehur në terma konkrete numri i auditimeve financiare do të rritet në 10 auditime financiare përgjatë vitit 2017.

#### ***-Implementimi i një sistemi efektiv të etikës dhe integritetit***

Në fokus të veprimtarisë menaxheriale institucionale është sigurimi i vijmësisë së implementimit të një sistemi efektiv të integritetit dhe etikës nëpërmjet zbatimit të kornizës rregullative dhe udhëzuese INTOSAI-t, të Kodit të Etikës dhe Rregullores së Organizimit Administrativ të KLSH-së.

Referuar faktit se ***Etika dhe integriteti janë komponentë kyç dhe parakushte*** për krijimin e besimit tek Institucioni Suprem i Auditimit, KLSH përgjatë vitit 2015 u angazhua edhe në hartimin e një kodi të ri të etikës i cili u miratua me Vendimin e Kryetarit nr 56 datë 30.04.2015.

Kodi Etik i KLSH-së reflekton praktikave më të mira të fushës duke u hartuar **si një dokument integral** ku janë përfshirë : Kodi Etik i KLSH-së, Kodi Etik i Gjykatës Europiane të Audituesve dhe ISSAI 30- Kodi i Etikës i INTOSAI-t .

Mund të konfirmohet se në Kodin e Etikës të KLSH-së për herë të parë një sërë parimesh dhe vlerash etike janë trajtuar **në një profil dhe optikë bashkëkohore** dhe në reflektim të sfidave me të cilat përballen *audituesit publikë në nivel global*.

Dimensioni etik në përgjithësi dhe ai integritetit në veçanti janë trajtuar jo vetëm si një kërkesë që duhet të përmbushet nga i gjithë stafi i KLSH-së por vlerat etike dhe integriteti janë trajtuar në një profil dhe nivel institucional si një nga përparësitë e veprimtarisë menaxheriale që tenton në krijimin e një stature institucionale që KLSH të jetë dhe *funksionojë si model i ekselencës etike dhe që udhëheq sipas shembullit*.

KLSH aktualisht është pjesëmarrëse aktive e dy organizmave të INTOSAI-t, referuar çështjeve të etikës dhe integritetit, Task Forca për Etikën dhe Grupi i Punës për rishikimin e ISSAI 30

Kodi Etik i INTOSAI-it. KLSH ka siguruar që i gjithë kuadri rregullativ dhe udhëzues hartohet nën frymën INTOSAINIT, për të promovuar integritetin, si karakteristikë kyçe e besimit të perceptuar nga Kuvendi dhe palët e interesit. KLSH ka miratuar së fundmi Rregulloren e re Institucionale, e cila vjen në frymën e IntoSAINT.

IntoSAINT është një instrument vetë-vlerësimi e cila po gjen përdorim gjithnjë e më të gjërë në komunitetin e INTOSAI-it dhe mundëson për vlerësimin e risqeve ndaj integritetit dhe maturitetit të sistemeve për të menaxhuar këto risqe. Rregullorja e re institucionale e organizimit dhe funksionit të KLSH-së miratuar më vendim të Kryetarit nr 85 datë 30.06.2015 së bashku me Kodin e ri të Etikës, miratuar në Prill 2015, si dhe të gjitha aktet e tjera të kornizës rregullative të KLSH-së përdorin këtë taktikë menaxheriale për të dizenuar një politikë adekuate integriteti, duke rritur ndërkohë ndërgjegjësimin e stafit auditues në këtë drejtim. Po kështu me Urdherin e Kryetarit nr 26 datë 27.01.2017 òPër ngritjen e strukturës përgjegjëse për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve është ngritur përgjegjëse konform përcaktimit të ligjit nr 60/2016 òPër sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve.

Aktualisht, forcimi i sistemit të etikës dhe integritetit është nder prioritetet e menaxhimit institucional dhe si anëtar i grupit *Task Force* për auditimin dhe etikën, ka ngritur tashmë strukturën e tij etike, **Sektorin e Etikës dhe Integritetit**, ka Kodin e tij të Etikës dhe në reflektim edhe të praktikave më të mira të institucioneve më të përparuara analoge ka ngritur edhe **Komisionin e Etikës**.

Komisioni i Etikës funksionon si organizëm ad-hoc i gjykimit profesional dhe mbulon çështjet që kanë të bëjnë me etikën dhe integritetin.

Në periudhën në vijim, KLSH synon:

- Realizimin e një auditimi të performancës òMbi vlerësimin e integritetit në institucionin e KLSH-së.

- Monitorimin në vijimësi të risqeve dhe maturitetit të sisteme të integritetit, etikës dhe disiplinës institucionale.

- Përgatitja e Raporteve të Monitorimit nga Sektori i Etikës dhe Integritetit mbi inspektimet e kryera.

- Monitorimi nga ekspertët e jashtëm dhe bashkëpunimi me agjencitë e tjera dhe OJF antikorrupsion.

**-Strategjia e Menaxhimit të Riskut të KLSH-së.**

Strategjia e Menaxhimit të Riskut të KLSH-së është një prej dokumenteve bazikë të veprimtarisë menaxheriale të KLSH-së miratuar me Vendimin e Kryetarit nr. 42 datë 30.03.2015.

***Qëllimi i Strategjisë është të sigurojë që koncepti i menaxhimit të riskut të jetë në themel të kulturës organizative nëpërmjet filozofisë së zvogëlimit të riskut dhe vlerësimit të tij, për çdo veprimtari që kryen institucioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit.***

Ky dokument përcakton parimet e përgjithshme të menaxhimit të riskut në Kontrollin e Lartë të Shtetit, metodë sistematike që përdoret për të identifikuar, analizuar, vlerësuar, trajtuar, monitoruar dhe komunikuar risqet kryesore që shoqërojnë përgjegjësitë e KLSH me qëllim minimizimin e ngjarjeve negative të paparashikuara dhe maksimizimin e mundësive.

Strategjia e Menaxhimit të Riskut në KLSH është hartuar mbështetur në ISSAI 9130 òUdhëzues për Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik- Informacion i zgjeruar për Menaxhimin e Riskut Institucional dhe në Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 òPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Strategjia gjithashtu i referohet përgjegjësisve dhe objektivave të vendosura në Strategjinë e Zhvillimit të KLSH 2013-2017, të rishikuar.

KLSH konsideron se për të qenë efektiv, menaxhimi i riskut duhet të bëhet pjesë e kulturës së KLSH e integruar në planet dhe veprimtaritë e përditshme të punës dhe nuk duhet parë si një

program i shkëputur. Në vijim, menaxhimi i riskut është detyrë dhe përgjegjësi e çdo punonjësi në KLSH, të çdo niveli deri në hierarkinë më të lartë drejtuese. Strategjia e Menaxhimit të Riskut fokusohet si në risqet e nivelit strategjik ashtu dhe ato operacional. Strategjia e Menaxhimit të Riskut në Kontrollin e Lartë të Shtetit, jep një qasje gjithëpërfshirëse dhe të strukturuar për të identifikuar, vlerësuar dhe menaxhuar riskun e institucionit. Ajo synon të ndërtojë dhe të nxisë zhvillimin duke u bazuar në rishikime të rregullta dhe procese të përditësimit të vlerësimeve.

***Ekipi i menaxhimit të riskut si komponent kryesor për një sistem efektiv të menaxhimit të riskut.***

Me vendimin e Kryetarit nr 161 datë 13.02.2016 me qëllim funksionimin e një sistemi efektiv të menaxhimit të riskut është ngritur dhe funksionon ekipi i menaxhimit të riskut të KLSH. Anëtarët e Ekipit të Menaxhimit të Riskut, bashkëpunojnë dhe bashkërendojnë veprimtarinë e tyre me titullarët e njësive strukturore, Drejtorët e Departamenteve dhe Drejtorive repektive në funksion të përmbushjes së përgjegjësiave menaxheriale në të gjithë procesin e identifikimit, vlerësimit, monitorimit të riskut me qëllim kryesor përmbushjen e objektivave të Departamentit / Drejtorisë si dhe të objektivave institucionale.

Po kështu në përputhje me kërkesat e Ligjin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin është në proces rishikimi regjistri i riskut për KLSH-në, me qëllim përditësimin e tij me risqet e reja të brendshme dhe të jashtme si në nivel institucional dhe strukturor.

I gjithë ky proces po i nënshtrohet analizimit përditësimit të kontrolleve në funksion të minimizimit të riskut.

**-Ndryshimet e strukturës organizative**

Ndryshimet dhe zhvillimet që kanë ndodhur në ambientin veprues të KLSH-së gjatë viteve të fundit, pritshmëritë që erdhën si rezultat i miratimit të Ligjit të Ri, nxorën në pah nevojën për rishikim dhe përshtatje të strukturës organizative dhe formave të bashkëveprimit midis njësive të Insitucionit.

Ndryshimet e Strukturës organizative kanë konsideruar mundësinë e plotësimit të strukturës organizative në funksion të një menaxhimi efektiv institucional, dhe një strukture sa më të qartë dhe të një shtresëzimi sa më optimal. Rishikimi ka konsideruar ndryshime të mundshme të përgjegjësiave dhe ndarje të roleve si për funksionet primare audituese ashtu dhe ato mbështetëse duke synuar një hierarki të përshtatshme dhe linja të qarta raportimi. Po kështu është synuar që të adaptohet një strukturë organizative fleksibël dhe që reflekton kërkesat e COSO model kundrejt pesë komponentëve për të siguruar sisteme efektive të kontrollit të brendshëm duke formuar në këtë mënyrë një system të integruar që reagon në mënyrë dinamike ndaj ndryshimit të kushteve eventuale.

Në funksion të arritjes së pritshmërie për modernizimin institucional si dhe implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI, është krijuar dhe funksionon Departamenti i Politikave të Auditimit, boshti kryesor i veprimtarisë të të cilit është hartimi i politikave të auditimit dhe mbështetja e departamenteve të auditimit gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre audituese. Po kështu është krijuar dhe funksionon Departamenti Juridik dhe i Zbatimit të Standardeve, në përberjen e së cilës është ngritur dhe funksionon Drejtoria e Kontrollit të Cilësisë dhe Zbatimit të Standardeve si dhe Sektori i Kontrollit në otë nxehtëdhe në të oftohtëo strukture kjo ne nje linjë dhe në përmbushje të objektivit strategjik të kryerjes së veprimtarisë audituese në një linjë me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI si dhe forcimit të komponentit të kontrollit dhe sigurimit të cilësisë konform kërkesave të ISSAI 40 për Sigurimi i cilësisë. Në funksion të objektivit të KLSH-së, për të bërë pjesë të praktikave të saj audituese dhe Auditimet e Teknologjisë së Informacionit u krijuar një drejtori e veçantë

Drejtoria e Auditimit të TI-së. Struktura organizative e KLSH-së reflekton kërkesat e nenit 12 të Ligjit nr nr. 10296, datë 08/07/2010 për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin për sa i përket kriterëve të linjave të raportimit dhe arsimimit për nëpunësin zbatues. Nëpunësi zbatues ( Përgjegjësja e Financës ka vartësi dhe raporton tek Sekretari i Përgjithshëm njëherazi nëpunësi autorizues i institucionit). Gjithashtu, u miratua me Vendimin nr. 85, datë 30.06.2015 rregullorja e re administrative organizative e institucionit. Ky dokument përmban rregullore për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së dhe mbështetet në parimet e zbatimit korrekt të ligjit të ri në rritje të transparencës dhe cilësisë së punës së auditimit.

Bazuar edhe në rekomandimet e adresuara nga ekspertet e huaj përgjatë procesit të implementimit të projektit IPA aktivitetit 0Shqyrtimi i strukturës aktuale sipas të cilit u rekomandua emërimi i strukturës së Drejtorit të Përgjithshëm u ndryshua struktura aktuale me emërimin e postit të Drejtorit të Përgjithshëm me fokus performancën audituese.

### **-Menaxhimi i Burimeve Njerëzore/Ngritja e kapaciteteve/Trajnimi dhe Zhvillimi Profesional i Stafit**

#### **Zhvillimi i burimeve njerëzore të institucionit.**

Objektivi strategjik i KLSH-së është që të përmirësojë vazhdimisht performancën institucionale dhe kjo mund të arrihet vetëm nëpërmjet një stafi i cili është i motivuar, është i mirë menaxhuar si dhe që shpërblehet në mënyrë të drejtë. Menaxhimi efektiv dhe profesional i Burimeve Njerëzore është jetik për të ndihmuar një institucion që ta arrijë këtë.

Për vitin 2016, me anë të Vendimit nr. 7, datë 03.02.2016 të Kryetarit të KLSH, për Strukturën e Renditjes së Punëve, Klasifikimin e Vendeve të Punës dhe Nivelin e Pagave në KLSH, i ndryshuar është miratuar struktura organike me një total prej 176 punonjësish. Nga viti 2011 dhe 2012 vite në të cilat struktura ka pasur një numër total prej 156 punonjësish ka ardhur duke u rritur me një shtesë prej 5 vendesh duke arritur në vitin 2016, përkatësisht 176 punonjës.

Në total numri i stafit Kryeauditues dhe atij Auditues në vitin 2016 është 127 punonjës (nga 123 në vitin 2015, 119 në vitin 2014, 113 në vitin 2013, 110 punonjës në 2012 dhe 2011 ) që zë rreth 72% të numrit total të punonjësve dhe ***struktura e punonjësve ka vijuar të ndryshojë në favor të stafit auditues.***

Me qëllim përmirësimin e performancës së tyre si dhe për të fituar njohuri, aftësitë dhe teknika të reja, një pjesë e punonjësve kanë përfunduar studimet në degë të dyta apo në certifikata të ndryshme të cilat bëjnë të mundur që ato ti përdorin aftësitë e tyre që tashmë i kanë, në mënyrë më efektive në situata të reja

Zbatimi i ligjshmërisë dhe praktikave më të mira të fushës në drejtim të rekrutimit, ngritjes në detyrë, trajnimit dhe zhvillimit të personelit, motivimit, marrëdhënieve dhe kushtet e punës, disiplinës janë në boshtin e veprimtarisë për një menaxhim efektiv të burimeve njerëzore.

Në këtë drejtim KLSH do të konsiderojë dhe dokumentin e politikave të burimeve njerëzore dokument i cili është në proces finalizimi produkt i IPA Projekt.

#### **Ngritja e kapaciteteve/Trajnimi dhe Zhvillimi Profesional i Stafit**


Edukimi profesional është një nga komponentët më të rëndësishëm në zhvillimin e kapaciteteve profesionale, identifikimin e mundësive për zhvillim të mëtejshëm dhe për më tepër krijimin e òtrupës profesionale në një Institucion të Auditimit Suprem. Trajnimi në KLSH shihet si një faktor ndryshimi drejt një evolucioni ku secili anëtar i stafit të krijojë vetëbesim, nivel të lartë profesional, bashkërendim të forcave audituese dhe klimë bashkëpunimi.

Me ligjin e ri organik 154/2014, KLSH përjetoi një reformim të madh në drejtim të implementimit të standardeve ISSAI të auditimit. Tashmë të përcaktuara me ligj, ato janë një

detyrim për aplikim në punën e përditshme audituese. Në funksion të këtij reformimi u pa si e domosdoshme aplikimi i një programi intensiv trajnimi për stafin e institucionit.


Bazuar në objektivin e Strategjisë për Zhvillim, 2015-2017, dhe në Programin Vjetor të Trajnimeve, gjatë 2016 janë zhvilluar **4,044**. Ecuria e këtij treguesi përgjatë viteve është:

**Grafiku 4: Ecuria e trajnimit në ditë persona të trajnuar ndër vite**



Stafi auditues, pa përfshirë Drejtorët e Drejtorive dhe të Departamenteve është 137 punonjës nga 123 punonjës që rezultonte në vitin 2015. Ecuria e këtij treguesi ndër vite është:

**Grafiku 5: Evolucion i trupës audituese ndër vite**




Ditë Trajnimi realizuar vetëm për stafin auditues janë 3,702 ditë trajnimi, me një mesatare prej 27 ditë trajnimi për auditues.

Programi i Trajnimit për Stafin e KLSH, sikurse në vitin 2015 dhe në vitin 2016 përfshiu veprimtari të trajnimit dhe zhvillimit të parashikuara për t'u ofruar audituesve njohuri të karakterit funksional dhe ideologjik. Për këtë programi i trajnimit është i organizuar drejt zhvillimit të metodologjisë audituese dhe praktikat e mira audituese botërore si dhe të njohjes me standardet e auditimit dhe normat e aplikuar nga institucionet homologe.

Si rezultat i implementimit të Programeve të Trajnimit përgjatë dy viteve 2015-2016 është arritur u arrit që çdo punonjës në KLSH të trajnohet me rreth 27 ditë trajnimi/person.

**Grafiku 6: Evolucion i ditëve mesatare të trajnimit ndër vite**



Të gjithë audituesit janë trajnuar në standarde, manuale dhe metodologji audituese. Në këtë mënyrë procesi i trajnimit ka plotësuar objektivat e strategjisë për Aplikimin e Standardeve të Auditimit, ISSAI, si dhe aplikimin e Indikatorëve të Performancës të Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike 2014-2020 (SMFP), indikator 6.1.3.

Në funksion të maksimizimit të cilësisë dhe larmisë së dijeve, në procesin e trajnimit është synuar diversifikimi i burimeve të informacionit.

#### **-Bashkëpunimi institucional . Bashkëpunimi me SAI-t partnere dhe Ndërkombëtarë**

Në zbatim të të gjitha orientimeve dhe realizimit të objektivave përgjate vitit 2016, janë ndjekur të gjitha procedurat për organizimin dhe zhvillimin e aktiviteteve të përcaktuara të cilat kanë pasur rëndësi strategjike për zhvillimin e KLSH-së.

Gjatë vitit 2015 dhe 2016 kanë marrë pjesë në aktivitetet jashtë vendit përkatësisht 136 dhe 153 auditues (nga 157 gjithsej) ose 775 dhe 765 ditë/njerëz në total, thënë ndryshe pothuajse të gjithë punonjësit e KLSH-së kanë qenë të paktën një herë jashtë vendit.

#### ***Internshipi i ECA-s dhe felloëship i GAO-s***

Në modernizimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit kanë dhënë një kontribut të çmuar Gjykata Europiane e Audituesve (ECA), nëpërmjet intershipeve dhe Zyra e Auditimit të Qeverisë së SHBA-së (GAO), përmes felloëship-eve. Falë kësaj asistence, në KLSH po krijohet një gjenerate e re audituesish, të trajnuar në ECA dhe GAO.

Përgjate dy viteve 2015 dhe 2016, 8 auditues të Kontrollit të Lartë të Shtetit kanë qenë pjesë e strukturave të ECA-s për një periudhë 5 mujore, duke përfituar nga programet e internshipit të kësaj institucioni, për të kontribuar pranë departamenteve dhe drejtorive të ndryshme të ECA-s. Internshipi është konsideruar një mjet shumë i rëndësishëm për të ofruar njohuri mbi auditimin e fondeve të BE-së, për audituesit e SAI-ve të vendeve që aspirojnë të bëhen anëtare të BE-së. Në total janë 9 auditues të KLSH-së që kanë fituar internship-et tek ECA, përfshirë një auditues që do të fillojë internshipin në mars 2017. Po ashtu produktive për KLSH-në ka rezultuar edhe bashkëpunimi me GAO-n e SHBA-së ku gjatë vitit 2016 një audituese e KLSH-së mori pjesë në një felloëship 4 mujor pranë kësaj zyre ndërsa gjatë 2017 dy auditues do të ndjekin këtë felloëship.

KLSH ka marrë pjesë në shumë grupe pune dhe aktivitete të organizuara nga INTOSAI dhe EUROSAL.



### ***Botimet e KLSH-së përgjatë viti 2016***

KLSH vjen në pesë vitet e fundit 2012-2016 me një kolanë botimesh prej 67 titujsh. Çdo vit dinamika e botimeve të institucionit rritet me 10 përqind dhe përçon drejtimet strategjike të reformimit të institucionit, që janë rritja e kontributit në përmirësimin e qeverisjes publike. Botimet e KLSH-së janë zbatim i detyrimeve ndërkombëtare të angazhimit të institucioneve të auditimit edhe në fushën e botimeve të dokumentacionit për të mundësuar qytetarëve një akses më të gjerë. Plejada e botimeve, e cila pasurohet nga viti në vit, pasqyron çdo kronikë të reformave që ka nisur KLSH për të modernizuar institucionin drejt parametrave të SAI-ve europiane. Nëpërmjet tyre, ne rrisim transparencën dhe llogaridhënien tonë si institucion, duke rritur njëkohësisht edhe besimin e qytetarëve ndaj punës sonë.

Gjatë vitit 2016, KLSH ka vijuar me sukses punën në këtë drejtim, duke i shtuar 51 botimeve të viteve 2012-2015, 16 botimet e 2016 duke e çuar ne 77 numrin total të botimeve.

Në frymën e standardeve të INTOSAI, konkretisht ISSAI 20, për transparencën dhe llogaridhënien, KLSH gjatë vitit 2016 ka realizuar 16 botime.

1. Revista e Auditimit Publik nr. 12.
2. KLSH Analiza Vjetore, 2015.
3. Audituesit e KLSH-së në Shtypin e Përditshëm. Volumi V.
4. Audituesit e KLSH-së në Shtypin e Përditshëm. Volumi VI.
5. Standartet Ndërkombëtare të Auditimit.
6. Direktivat e BE-së mbi Prokurimin Publik dhe Kontratat Konkensionare.
7. Auditimi i Performancës në KLSH.
8. Forcimi i kapaciteteve të auditimit të jashtëm në Shqipëri. (Shqip-Englisht)
9. Revista e Auditimit Publik nr. 13
10. ALSAI Performanca 2015
11. Raporti Vjetor i Performances KLSH 2015
12. Konferenca e IV Shkencore Analiza e Riskut, V I
13. Revista e Auditimit Publik nr. 14
14. 4 Vjet Auditim i Jashtëm Pubik
15. Konferenca e IV Shkencore Analiza e Riskut, V II
16. Eksperienca e Vendeve Evropiane

### ***Konferenca Shkencore “Mbi Riskun Në Auditim”.***

Në vitin 2016 u zhvillua konferenca shkencore mbi òRiskun në Auditimò. Kjo konferencë e katërt shkencore u zhvillua në bashkëpunim me stafet akademike universitare dhe institucionet profesionale dhe kërkimore shkencore, me partnerët tanë homologë ndërkombëtar të SAI Polak, Malit të Zi, Turk, Kroat, shoqëria civile si dhe deputetë të parlamentit evropian. Si formë e avancuar e zhvillimit profesional, konferenca e organizuar në formën e diskutimeve dhe debateve, përcolli një sërë mesazhesh në drejtim për përmirësimin e punës audituese të auditit të jashtëm në vend. Konkluzionet dhe rekomandimet e kesaj Konference do të merren si bazë për përmirësimin e punës së audituesve të brendshëm dhe bashkëpunimin me KLSH nga ana e Ministrisë së Financave. Menaxhimi i faktorëve të riskut në mjedis do të jetë objekt i një auditimi performance nga KLSH për të parë efektivitetin e investimeve, si janë menaxhuar faktorët gjatë procesit të planifikimit të fondeve dhe implementimit të projekteve dhe se si agjencitë e zbatimit i realizojnë programet e tyre për menaxhimin e riskut.

### **Mbi implementimin e projektit të binjakëzimit “Forcimi i kapaciteteve të auditimit jashtëm” nën programin IPA 2013**

Për vitin 2016, janë parashikuar fonde për realizimin e projekteve me Financim të Huaj në vlerën 135,000 mijë lekë dhe që i përket projektit IPA 2013 “Forcimi i kapaciteteve të auditimit të jashtëm”. Shpenzimet për kontribuimin nepermjet kategorise kosto lokale ne plan rezultojnë 6,900 mijë lekë. Realizimi i fondeve për te dy kategorite e shpenzimeve rezulton:

/000 Lekë

Llog	Kod Projekti	Emertimi i Projektit	Buxheti 2016	Buxheti i Rishikuar	Fakti	Vlera e mbetur
		Projekti IPA -Forcimi i kapaciteteve te auditimit	100.000	135.000	132,479	2.521
		Kosto lokale projekti IPA	6.900	6.900	1.571	5.329
		<b>Shpenzime Kapitale/Investime</b>	<b>100.000</b>	<b>141.900</b>	<b>134.050</b>	<b>7.850</b>

Pas nënshkrimit të kontratës në 17 shkurt 2016 në 16 mars 2016 filloi implementimi i këtij projekti binjakëzimi në bashkëpunim me Zyrën Kombëtare të Auditimit të Polonisë dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Kroacisë. Ky projekt me vlerë 2, 1 milion dollar do të implementohet brenda 24 muajve. Është planifikuar që për realizimin e këtij projekti të kryhen 92 misione objektivat kryesore të të cilit janë:

- Përmirësimi i e kornizës ligjore për auditimin;
- Zhvillimin e metodologjive të auditimit dhe kapaciteteve audituese, si dhe forcimin e kapaciteteve institucionale të KLSH;
- Forcimi i kapaciteteve institucionale dhe përmirësimi i impaktit të rezultateve auditues të KLSH-së

Prej fillimit të projektit dhe deri në fund të dhjetorit 2016 janë zhvilluar 36 misione në të cilat ekspertët polak e kroatë në bashkëpunim me drejtues e auditues të KLSH kanë synuar përmirësimin e objektivave të sipërcituara.

**Përmirësimi i kornizës ligjore të auditimit është objektiv kryesor** i cili synon për përmirësimin e akteve ekzistuese ligjore, miratimin e dokumenteve akte të tjera me synim përmirësimin e aktivitetit auditues. Në pesë misionet e kryera nga ekspertët polak kanë analizuar legjislacionin primar dhe sekondar mbi të cilën ushtron aktivitetin KLSH dhe kanë hartuar dokumentet e mëposhtme:

- Analiza e kornizës ligjore të KLSH vis-à-vis deklaratave të INTOSAI-t dhe standardeve të tjera ndërkombëtare;
- Analiza e kornizës ligjore të KLSH-së vis-à-vis modeleve të shteteve anëtare të BE;
- Analiza e aplikimit të ligjit dhe identifikimi i barrierave të mundshme për implementimin e ndryshimeve të paraqitura;
- Koncepti i një komentuari për rregulloret e reja;
- Udhëzues praktik për implementimin e ligjit të ri të KLSH-së në fusha të veçanta;
- Plani i veprimit për draftimin e akteve nënligjore;
- Analiza e rishikimit të rregullores së brendshme dhe propozimet për mendimin në përputhje me ligjin e ri të KLSH dhe qasja e re për auditimet e përputhshmërisë, auditimin financiar dhe atë të performancës;
- Analiza e akteve rregullatore për marrëdhëniet e KLSH me parlamentin dhe praktika konkrete për marrëdhëniet midis dy institucioneve;
- Draft udhëzuesin për institucionalizimin e marrëdhënieve të KLSH me parlamentin si dhe plani dhe masat për implementimin e këtij udhëzuesi.

Detyra kryesore e Institucioneve Supreme të Auditimit është të shqyrtojë nëse fondet publike shpenzohen ekonomike dhe efikase, në përputhje me rregullat dhe rregulloret ekzistuese. Ashtu siç theksohet edhe në preambulën e planit strategjik të INTOSAI-t 2011-2016 në të

cilin një nga objektivat kryesore ishte ndërtimi i kapaciteteve *“ ò e rëndësishme është që metodat e auditimit të SAI-eve të bazohen në njohuritë aktuale shkencore dhe teknike dhe që audituesit të kenë kanë kualifikimet e nevojshme profesionale dhe integritetin moral”* për të përmbushur parimet e pavarësisë, integritetit, profesionalizmit, besueshmërisë, gjithëpërfshirës, bashkëpunimit dhe inovacionit mbi të cilën duhet të mbështetet puna dhe aktiviteti i tyre auditues.

***Përmbushja e objektivit të dytë të projektit për zhvillimin e metodologjive të auditimit dhe kapaciteteve audituese*** përbën numrin më të madhe të aktiviteteve të planifikuara në projekt. Për periudhën mars- dhjetor 2016 për këto objektiv janë zhvilluar 22 misione të cilat është punuar në drejtimet e mëposhtme:

- Përmirësimin e metodologjisë audituese për luftën kundër korrupsionit dhe mashtrimit;
- Zhvillimin e mëtejshëm të qasjes bazuar në risk në auditimet financiare dhe atyre të përputhshmërisë nëpërmjet asistencës së ekspertëve polak në hartimin e planit vjetor të auditimit për 2017;
- Shqyrtimit dhe përditësimit të manualit të auditimit të performancës, si dhe trajnimi i auditueseve në këtë fushë;
- Inicimin e punës për zhvillimin e manualit të auditimit të teknologjisë së informacionit, zhvillimit të moduleve për auditimet standarde për auditimet IT dhe krijimin e një help desk-u për auditimet IT;
- Zhvillimin e metodologjive për sigurimin dhe kontrollin e cilësisë.

Nga 22 misionet e kryera 5 prej tyre kanë përfunduar. Kështu ekspertët kanë shytuar sistemin e luftës kundër korrupsionit dhe mashtrimit në Shqipëri, rezultatet e KLSH në fushën e zbulimit të këtyre fenomeneve, kanë trajnuar 50 punonjës të KLSH dhe kanë përgatitur një manual lidhur me çështjet e luftës kundër korrupsionit dhe mashtrimit.

Në drejtim të përmirësimit të kapaciteteve ekspertët polak kanë paraqitur ***një kuadër të procedurave të planifikimit***, me afate kohore që mundëson kohë të mjaftueshme për të gjithë fazën e planifikimit e cila lidhet ngushtë me vlerësimin e riskut, modelin e kartës së planifikimit të auditimit dhe dokumentin për përlllogariten e ditëve të auditimit për çdo auditues. Në kuadër të përmirësimit të metodologjive audituese nga ekspertët janë shqyrtuar dy auditime financiare të kryera gjatë vitit 2016 dhe janë dhënë rekomandimet për përmirësime të mundshme në fusha të caktuara të auditimit financiar dhe atij të përputhshmërisë.

Për vetë natyrën e ndryshme nga auditimet klasike, ***auditimi i performancës*** kërkon zhvillimin e metodologjive të cilat ecin me zhvillimet dinamike të ekonomisë dhe teknologjisë. Në këtë kuadër ekspertët kroat pas shqyrtimit të manualit ekzistues të auditimit të performancës, bazuar edhe në praktikën më të mira të fushës ***kanë paraqitur rekomandimet për përmirësimin e këtij manuali***.

Ekspertët në bashkëpunim të ngushtë me drejtues dhe auditues të KLSH do të vazhdojnë të punojnë gjatë vitit 2017 lidhur me hartimin e manualit të auditimit të teknologjisë së informacionit dhe hartimin e udhëzuesve dhe metodologjive dhe kontrollin dhe sigurimin e cilësisë.

Një rëndësi të veçantë për institucionet supreme të auditimit ka impakti i rezultateve të auditimit për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies. Për këtë qëllim në përmbushje të objektivit të tretë të projektit të ***binjakëzimit “Forcimi i kapaciteteve institucionale dhe përmirësimi i impaktit të rezultateve auditues të KLSH-së”*** janë zhvilluar 36 misione të cilat kanë shqyrtuar aktivitetin e KLSH dhe synuar përmirësimin në:

- Planifikimin e ndryshimeve në menaxhim;

- Shqyrtimin e situatës aktuale të burimeve njerëzore në KLSH dhe hartimin e përmbajtjes së politikave në këtë fushë si dhe draftimin e politikave dhe një udhëzuesi;
- Shqyrtimin e komunikimit të KLSH, përcaktimin e detyrave dhe mjeteve për strategjinë e komunikimit;
- Komunikimin e brendshëm dhe përcaktimin e nevojave për komunikimin e brendshëm dhe zhvillimin;
- Shqyrtimin e procedurave aktuale të auditimit lidhur me sigurimin e transparencës duke siguruar rritjen e besimit të opinionit publik tek institucioni.

Tetë prej këtyre misioneve ***kanë përfunduar tërësisht duke rezultuar me***

-Paraqitjen e një dokumenti mbi analizën e riskut në planin e komunikimit dhe të rekomandimeve për këtë çështje;

-Prezantimin e rezultateve të rishikimit të situatës së burimeve njerëzore në KLSH dhe rekomandimet për përmirësimin e saj si, paraqitjen e një raporti për këtë çështje dhe përmbajtjen e dokumentit për politikën e burimeve njerëzore;

-Prezantimin e një liste për qëllimet strategjike në fushën e komunikimit dhe skemën për kanalet e komunikimit të brendshëm.

Implementimi i projektit ka pasur qëllim në vetvete gjithashtu edhe trajnimin e stafit të KLSH në fusha të ndryshme ku mund të përmenden trajnimet për luftën kundër korrupsionit dhe mashtrimit, trajnimet për auditimin IT, trajnimet për auditimin e manualit të performancës dhe trajnimet për komunikimin. Në periudhën mars- dhjetor janë kryer 9 aktivitete trajnuese me pjesëmarrjen e 154 drejtuesve dhe audituesve për shumën 532 ditë/njerëz.

***Deri në fund të Dhjetorit 2016 ekspertet e Projektit IPA për të 36 misionet e kryera kanë adresuar 107 rekomandime, për të cilat KLSH po punon për hartimin e planit të veprimit për implementimin e tyre.***

***KLSH ne vijim me burimet financiare disponibel do të vazhdojë përpjekjet institucionale të cilat synojnë modernizimin dhe reformimin e institucionit me qëllim që të reflektojmë tiparet dhe standardet ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit INTOSAI dhe fokusimin e veprimtarisë audituese me impakt, forcimin e llogaridhënjes publike, të integritetit, transparencës institucionale.***

---

**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM**

**Luljeta NANO**

